



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

RELACION TEKNIK

**Objekti: "Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit
dhe Njësive Administrative , Bashkia Shkodër ".**

Përshkrimi i shërbimit

Lëvizshmëria e automjeteve dhe siguria në rrugë gjatë periudhës së vjeshtës dhe dimrit, kryesisht në Njësitë Administrative malore por dhe ato fushore, është e kufizuar për shkak të motit të paparashikueshëm me reshje dhe ngrica. Për të paraprirë këtyre situatave kërkohet një qasje sa më fleksibel në sigurimin e shërbimeve të nevojshme dhe në mungesë të kapaciteteve logjistike të Bashkisë është e nevojshme realizimi i këtyre shërbimeve me Sipërmarrje Private.

Duke parë shtrirjen shumë të madhe gjeografike të rrjetit rrugor në njësite administrative si në terren fushor ashtu dhe malor, nisur dhe nga eksperiencia e viteve të mëparshme, është bërë parashikimi i materialeve dhe makinerive për të riparuar në kohe sa më të shpejte dëmtimet nga fenomenet natyrore në rrjetin rrugor dhe me gjere.

Për të përballuar situatat emergjente të shkaktuar nga kushtet e rënduara atmosferike duhet ndërhyrje për:

1. Sigurimin e qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të rrjetit rrugor nëpërmjet shërbimeve të mirëmbajtjes emergjente;
2. Përmirësimin e kushteve të levizjes dhe rritjen e sigurisë rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës;
3. Ndërhyrjen në kohë për zhbllokimin dhe përmirësimin e lëvizshmërisë në lidhjet e rrugëve rurale me rrugët nacionale, qendrat e fshatrave me rrugët nacionale dhe qendrat e fshatrave me rrugët brenda njësite administrative;
4. Pastrimin e bores ;
5. Shmangien e ngricave ;
6. Masat kundër akullit ;
7. Pastrimin e karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera.
8. Pastrimin e materialeve të rëna në rrugë nga rrëshqitjet e shpateve.
9. Shperndarjen e kripes me shperndares automatik te lidhur per automjeti (sipas specifikimeve teknike). Kripa sigurohet nga Autoriteti Kontraktues .

Per te perballuar situatat e mesiperme jane parashikuar mjetet e punes dhe punetoria si me poshte :

Nr	Analiz	Materiali	Njesi	Sasi
	A	Mirembajtje e rrugeve te qytetit		
	Eksp	Dispozicion bore pastruese per hapje rrugeshe dhe shperndarje krye	ore/pune	140
	Eksp	Dispozicion fadrome per hapje rrugeshe nga shembjet.	ore/pune	50
	2.37/5b	Transport	m3	50
		Puntori	ore/pune	200
	B	Mirembajtje e rrugeve ne Nj.A		
	Eksp	Dispozicion bore pastruese per hapje rrugeshe dhe shperndarje krye	ore/pune	300
	Eksp	Dispozicion fadrome per hapje rrugeshe nga shembjet.	ore/pune	100
	Eksp	Dispozicion fadrome per hapje rrugeshe nga shembjet dhe me matrapik	ore/pune	65
	2.37/5b	Transport materialesh nga shembjet,(perdor dhe per mbushje)	m3	105
		Puntori	ore/pune	249

Detyrimet e Kontraktorit gjatë situatave emergjente

Kontraktori do të ketë përgjegjësi të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të situatave emergjente për të siguruar nivelet normale të shërbimit për të gjithë seksionet që preken nga emergjencat.

Nëse trafiku në rrugë ndërpritet si rrjedhojë e një emergjence, atëherë Kontraktori do ndërmarrë gjithë masat e nevojshme si:

- ✓ Të rihap trafikun sa më shpejt të jetë e mundur .
- ✓ Të mirëmbajë rrugën e hapur gjatë punimeve emergjente.

Kjo vlen për të gjitha rrethanat emergjente siç janë erozione në rrugë dhe bankina, rënia e gjithë skarpatës, përmbytjet, etj.

Vlera e shërbimit

Fondi limit për objektin: "Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative , Bashkia Shkodër " është vlera **3,332,982 leke pa tvsh**.

Afati i zbatimit

Shërbimi do të realizohet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, në periudhën e kërkuar prej tij për përdorim sipas nevojave për rastet emergjente të rrugëve në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër.

Afati i shërbimit: fillon me nënshkrimin e kontratës dhe përfundon me 31 dhjetor 2024.